Tashti besoj që të gjithë e dijmë se si vetë shqiptarja si shpend hyjnor në mitologjinë shqiptare simbolizon Zeusin , si kryezot dhe është barazi me vetë ZOTIN apo Njëshin e Universit.Kurse në te krahët e saj simbolizojnë energjitë e kundërta , plus dhe minus – mir +keq ., sheqer + zehër , dimër+ verë etj. Githatu mund të keni vënë re , se si shqiptarja në vete është një zog i madh. Kurse e veçanta e emrit të këtij zogu te shqiptarët qëndron në atë se mu ky emër si të asnjë popull tjetër simbolizon njëkohësisht edhe emërtimet e klerarkisë familjare te shqiptarët e Rumisë në dialektin e tyre .Dhe kjo i bënë ata të respektojnë emrat e vet te të gjithë të parëve të racës së vet , sipas parimit të Lebonit të cekur në fillim duke kushtëzuar që emri në gjenezën e trungut të tyre familjar si gjak të jetë i trashëgueshëm . Ruajtja e gjenezës familjare nga emrat , për të cilët cekëm ka krijuar historinë e sojit të trungut familjar deri në lashtësi dhe pikërisht përsëritja e emrave bënë të mendohet se si në këto hapësira të jenë banorë të parë që cek historitë e mitit si racë e quajtur nga autorët e antikitetit si ilir të pastër.E këtë e verteton edhe vetë origjina e ruajtur të gjakut të pastër hyjnor dhe siç kemi konfirmuar më heret edhe sot e kësaj dite ruajmë mbi 50 % të gjakut të pastër hyjnor –alienë . Të dhënat flasin që në gjak jemi mbi 30 përqind gjak i pastër nga Kadmosi ilir dhe 19 % nga Harmonia hyjnore apo bijë e Afërditës që mungon te ilirët tjerë . Kurse nga ana tjetër , siç cekëm nuk është i vogël numri i autorëve të cilët thonë se ilirë të pastër janë fiset që jetojnë nga grykderdhja e lumit Dri në jug të Adriatikut e deri te Gjiri i Kotorrit në veriprendim , kurse në veri ky gjak i ilirëve të pastër arrin deri në malet e Durmitorit. Shih për ilustrim se si në qytetin e Kotorrit(Mali i Zi) , ndodhën gjithë kishat dhe manastiret si: Katedralja e Shën Trifunit, kisha e Shpirtit Shnjtë , kisha e Shën Nikollës, Kisha eZojës së Bekuar , Kisha eShën Marijes,. Kishs e Shën Ilisë,Kishae Shën Lukës,Kisha e Shën Anës ,kisha e Shën Marisë, Kisha e Shën Mhillit ,kisha eShën Josifit , kisha e Shën Palit Kisha e shën Klarës, kisha eShën Pjetrit etj dh ku emri i këtij qytetit gjendet edhe në folklorin popullor i njohur edhe si Krajli i Kotorreve të Reja.

Po përse u desh të numërohen gjithë këto shenjtorë që njohën Zotin , sepse të gjithë së bashku tregojnë lulzimin e besimit të vjetër shqiptar në një Zot ,si parakusht për të pasur një terren ku më vonë në kohë një terminologji leksikore monoteiste shqipe te ajo pjesë e popullit e cila nuk u asimilua , kurse në këtë qytet u asimiluan .Pra mos pyesni veten : “po çynë këtu , kjo hyrje për të folur atë që nuk e kemi ditur për Hafiz AliRiza Ulqinakun..?! Dhe neve , sot lirisht mund të konstatojmë që për dërsisa arkitektura e shenjta religjose në bregdetin malazez që nis me Ulqinin e deri në Kotorr dëshmon se këtu në qytetin e Kotorrit dikur kish një aristokraci ilire

religjioze e cila sot mjerisht ka humbur , po të mos ishte si praktikë e shkruar në vargje shqip Mevlydi i Ali Riza Ulqinakut , mbase edhe kultura islame të shqiptarët e besimit islam do të ishte asimiluar në atë boshnjake . Të kënduarit shqip në një Zot e afroi atë më afër masave popullore dhe nga se merremi me gazetari investigative hetuam në një rast se një veteran i organizimit politik shqiptar kishte qenë i akuzuar para komunitetit komunist , jo sepse kishte shkruar në Xhami, por përse kishte shkruar atje deri sa po këndohej Mevlydi i Hafiz Ali Riza Ulqinakut. Pra pa dyshim po të mos ekzistonte kjo traditë e këndimit shqip për jetën e profetit zor se do të kishim pritur të dëgjojmë mësim nga ndikimet nga jashtë . E mbase sot do të kishim pasur një ndarje brenda vetë besimit islam . Fakti që në simbolikën popullore dhe në krijimet artistike Hafizi ruajti emrin ZAT ,në vend të atij Allah ka mundësuar që ai të vazhdonte të njëjtit gjuhësisht si një dhe ska tjetër .

Duhet shtohet se te shqiptarët rreth Rumisë ruajtja e emrit ZOT(Zat)në këto anë simbolikisht në traditën popullore emërton edhe të Zotin e Shtëpisë që haset pastaj në të gjithë hierarkinë e plotë hyjnore të së folmës së Rumisë në titujt e anëtarëve në një familjeje . Dhe kjo si asku tjetër , kujto këtu epitetin që po epërmendim si : “ Zat Shpije ”.


Evidentohet se në këtë situatë në dialekt , emri Zot , kalon në ZAT dhe më pas sipas titujve të hierarkisë hyjnore familjare të rumisë që asocon në kujtesë origjinën e tyre hyjnore sipas mitit dhe folklorit të shenjtë emri ZOTI shpesh kalon në të folme si ZOTNI, që në etimologji shohim se ka kuptimin ; ZOTI NJI (NI)- siç mëson feja , ose edhe Zoti i Ri , kurse emri Zot për gjininë familjare natyralisht bëhet Zojë – pra jo ZOTE ; shih për shembull, kur në popull thuhet : Zojë grupe, apo e ZOJA punës e për fëmijën e Zojës , nën Rumi , hasim edhe shprehjen që nuk e ndeshim në trevat tjera shqipfolëse që është Zog .Pra , shënohet se si ulqinaku thotë për fëmijën e vet edhe ZOGU jem ...?! Po po të pyesni përse gjithë ky konstatim e kjo për të arsytuar thënien e cekur si më poshtë:

“... Të vdekurit janë zotërit e pa diskutueshëm të të gjallëve”- Lebon?!- Dhe se : “ Një popull udhëhiqet nga të vdekurit e tij, më tepër se sa nga të gjallët e tij. Raca e tillë është e derdhur vetëm prej tyre. Shekull pas shekulli ata kanë krijuar idetë dhe ndjesitë tona dhe për pasojë edhe motivet e sjelljes sonë. Brezat e shkruar nuk na imponojnë ne vetëm konstitucionin fizik të tyre. Ata na imponojnë edhe mendimet e tyre?!Te vdekurit janë zotërit e pa diskutueshëm të të gjallëve. Ne mbajmë peshën e gabimeve të tyre, ne marrim shpërblimin e virtyeteve të tyre..”?!- **Gustav Lebon, Psikologjia e Racave, Reklama Tiranë2001,f 12**

E neve kemi të shtojmë , që ne bartim dhe përjetojmë edhe artin e tyre në të tre kuptimet –sepse ne kemi të njëjtin fjalor simbolik të folklorit , të njëjtën vije melodike dhe të njëjtin folklor dhe kjo vlenë edhe për baladat me të cilat u këndojmë ndodhive tona të parëve tanë që kanë hyrë në to . Pastaj falë veshjeve jemi tepër emocional dhe reagojmë njëllëj te ngjyrat e njëja e poashtu del të kemi të njëjtin medalon muzikor si racë ekzistuese e mbijetuar me gjuhë , mit dhe besim që nga zanafilla e tij . Bile shpesh mbase keni hetuar që na pëlqejnë edhe këngët e atyre popujve biblikë , me të cilët nuk del të jemi fqinjë , si puna e kolonave muzikore hebraike....?!!

Kështu pa dyshim që të parët tonë , për dallim prej shumë popujve të tjerë që kanë pasur sukses të ruajnë traditat dhe besimin , por jo edhe gjuhën , neve shqiptarët të njohur si” ilir të pastër” - të cekur -Grykëderdhja e lumit Bunë ..., kemi pasur fatin që nga të parët tonë të i trashëgojmë edhe me gjuhë edhe me karakter etnopsikologjik edhe me folklor edhe me besim të njëjtë. Prandaj në se na qenkësh kështu , atëherë “vetë koha e shkuar dhe e shkruar e jona është ajo që na përcakton të tashmën-siç tha Lebon ...?! Sepse tek të tjerët vërejmë edhe faktin se jo të gjithë hebrejntë flasin hebraishtë edhe pse besojnë në të njëjtin profet- Moisiun.Shih edhe një karakteristike tjetër për sa u përket përputhjeve në tradita të veshjes dhe të medalonit të njëjtë muzikor te të gjithë popujt e Ballkanit(Ilirisë së dikurshme)- poshtë lumit Sava , e duke zbritur poshtë Danubit në të djathtë dhe në të mëngjër del të kanë të njëjtën vijë muzikore me shqiptarët dhe të njëjta veshje për femra , ku vetëm burrat serbë del që për veshje komtare të kenë uniformën e Luftës së ParëBotërore ?!”. Prandaj ajo që njihet si muzikë ballkanike, do kish qenë më drejtë të quhet muzikë Ilire. Kurse kjo nuk lejohet të thuhet ?!. Në fakt të thuhet nga ne shqiptarët ?!

Ndërsa për sa i përket çështjes së hapur hetohet gjithashtu se mbi Savë e deri te Alpët , kemi një mezo zonë ilire (përzierje) , para se ajo të shkrihej në një medalon muzikor gjermanistik dhe kjo është fare e hetueshme.Tjetër mbi serbi e lartë në Rrumani e Thraki ...kemi poahtu legjenda , mite e muzikë fare identike me atë të popullit tonë...?!Doemos se kjo nuk ka të bëjë me turq , siç pohojnë disa ashtu siç jemi mësuar ta komentojmë sepse Rrumunija nuk ka qenë kurrë e pushtuar nga turqit ,për të na pëlqyer muziaka e tyre dhe gjuha , por duhet të flitet për afritë që kishin ilirët me rrumunët dhe thrakët e në të cilat afrime udhëzojnë edhe autorët antikë.Kurse sa për simbolin e shqiponjës , shqiponja si shpend i shenjtë tek ilirët duket se është më shumë se kaq dhe del se na bëhet si simbol i lirisë që në esencë i bie të ish vetë perëndi egjiptiane Thot të cilin e arriti Albanoli .Ose edhe kjo hartë gjaku tregon shtrirjen e njëjtë të gripit të gjakut të faraonëve egjiptian



DITA E VIDOVDANIT DHE MASHTRIMET SERBO OSMANE PËR NJË BETEJË INEKZISTENTE NË FUSHËKOSOVË

Këtu në fillim nuk mund të lëmë pa sqaruar se si emri Vida nuk ëdhtë emër vetëm serbë , por është edhe emër malësor shqiptar që edhe sot ruhet në këto anë , kurse me këtë emër njihet një lloj pëllumbi që zakonisht simbolizon paqen dhe sjell lajmin e mirë- bartë letra . Ndërsa te serbët nëse ruhet si emër njerëzish nuk është njëkohësisht edhe emër pëllumbi dhe ky është një dallim tejet i madh., Kurse edhe emri Kosovë , mos të mendohet se Kosovës iu dha nga serbët duke kuptuar kështu në gjuhën e tyre siç pretendojnë mullizezën që është s shpend karakteristik i atij vendi sepse nga ana tjetër me këtë emër Kosovë banorët e kohës së Aristotelit thotë që ata quanin mullizezën , në vendin kur flet për shpendët . Historiografia e mendimit intelektual si duket duke qenë e themeluar nga Beogradi dhe e finasuar edhe sot prej tyre , si shkollim nuk duan ta çvarrosin këtë emër për të i bërë autopsinë e tij thënë në mënyrë figurative. Pra serbët që sot janë në Kosovë apo në serbi historia mëson që ata nuk e arritën aty ku janë kohën e .

Sa për mashtrimin serb të radhës , pas emërimit që shpikën serbët , bashkë me mendimin oficial të akademive shqiptare një dëshmi e radhës është edhe shakaku i takimit të një betejeje të simuluar serboturke që do të ckim në vazhdim e ku edhe këtu është bërë modë të fshihet se si Skenderbeu e tradhtoi Sulltanin duke iu shmangur një beteje me koalicionin perëndimor për të arritur si shqiptar në zotërimin e tokave të babait të vet e duke motivuar gjithë feudalët shqiptarë me besëlidhjen e Lezhës diku pak më vonë në kohë pasi kish ndodhur Beteja E Fush Kosovës. *Sot me sa thuhet nga qarqet historike për Betejeën dy familjet e oborreve , ajo e sulltanit dhe ajo e serbëve, me një marrëveshje paraprake përgatiten një simulim të luftës në mënyrë si e si të përmbysin rivalët e vetë të anëtarëve tjerë të familjeve për frone në Serbi dhe në Kodovë dhe kështu po duket se si zbuluan “ armikun e brendshëm” dhe gjoja realisht për këtë edhe ngjau kjo betejë të cilën na mëson historiografia . Shih se këtu në këtë punë kish kurthe oborrësh mbretëror dhe të sulltanit sikur na e zbulon fakti që menjëherë pas kësaj- fare shpejt në mes dy armiqve u vendos paqja .E nga ana tjetër del që serbët , kurrë nuk bënë më gjatë historisë një luftë të njëmendtë kundër sulltanit , për dallim prej shqiptartëve ...?!Dhe se gratë e tyre -të mbretërve serbë pas betejave gjithnjë me dëshirë përfundonin në haremin e sulltanit e shqiptaret e refuzonin këtë ...?!!*

Po nëse i kthehemi për plotësim shpjegimit të emrit Vidë , mësojmë se të shqiptarët bëhet edhe emër femre dhe të cilës për nga atributet e cekura shënon një emër përkledhës të shenjtë”: “ Vidi , vidi , pllum i shkrum “...?!

Tjetër , në se arti tregon të vërtetën në një tabllo të caktuar betejash thuhet se në këtë betejë heroina Vidë fillimisht paraqitej duke u dhënë ujë ushtarëve të plagosur serbë e veshur me tesha kombëtare të zonës që në simbolikën popullore paraqesin vetë shtresën e shoqërisë shqiptare që merresh me mjeshturinë e luftimit. Pra heroina nuk del e veshur fare me rroba serbe si në tabllonë

e sjellë , por përkundrazi na del e veshur me tirqi , xhamadan dhe plis të bardhë që serbët u përkujdesën ta zhdukin..?!



Po -Çfarë ka ndodhur dhe ndodhë edhe sot nga ajo ditë që i bie , më 15 qershor, në fakt me 28 1389 të njohur si Dita e Vidovdanit Serb , ku u ndesh “ ushtria serbe” me ushtrinë e sulltanit turk e cila edhe sot është një mister i madh kur thuhet që brenda një dite apo një pjesë të saj u vranë nga 100 mijë ushtarë në të dy krahët. E pyetjet që nuk marrin përgjigje janë si më poshtë , por fillimisht le të flasim përmbledhtazi , për se ngjau që dora djathtë e sulltanit në fushëbeteja SkenderBeu del prej natyrës së vetë duke ikur nga fushëbeteja me hungarezët të Nishi dhe vjen dhe e çlirton Krusën në Shqipëri , duke i bindur zotëruesit turq të Krujes seky ishte urdhër i Sulltanit?!

Faktet flasin krejt të kundërtën e asaj që na kanë mësuar për Skender Beun ata të historiografisë akademike shqiptare. Për të mos e zgjatur është zbuluar se ekziston edhe një roman historik i shkruar nga një italian i cili jep fakte fare tjera për se Skender Beu e tradhëtoi sulltani e që duhen marrë në konsideratë . Ndër dëshmitë që sjell autori , ai përmend se “ Shpata e Sulltanit – Skender Beu “ arriti në këtë metropolë të kohës ashtu si edhe sot me dëshirë që të kryej akademinë ushtarake dhe të bëhej udhëheqës në ushtrinë e sulltanit. Thuhet që pasi binte në sy me trupin e tij prej atleti ate filloi ta pëlqejë vetë vajza sulltanit të cilën e dashuronte edhe vetë Skender beu dhe kështu ngjau përmes vajzës së Sulltanit SkenderBeu arriti ta bindë Sulltanin se do ta kishte gjithnjë aleatë në beteja me ushtritë e huaja dhe ashtu ndodhi, fama e SkenderBeut hpejt mori dhenë. Por çfarë ndodhi pa pritmas ?! Sulltani edhe përkundrejtë dashurisë së vajzës së tij për Skender Beun për qëllime tjera vendosë të tradhëtojë të bijën po dhe Skender Beun dhe për çudi te dy të rinjve vendos që bijën e tij ta martojë për mbretërinë serbe dhe kjo tërboi jashtë mase Skender Beun , kurse vetë vajza e sulltanit smuret rëndë dhe vdes .Pas këtij akti merret vesh që skender Beu kthehet në Krujë duke u bërë kundërshtar i përbetuar i Turqisë dhe i mbretërisë serbe që vazhdoj të jetë i tillë deri në vdekje..?! Tash pasi e zbuluam motivin e armiqësisë ë historiografija shqiptare me dekret e fsheh këtë ngjarje le të vazhdojmë me dekonspirimin e fakteve tjera që hapin dilema edhe në ditët tona që janë:

- Nëse vërtetë ndodhi kjo ndeshje kaq e madhe në Fushë Kosovë në ditën e cekur , atëherë : ku janë sot varret e të rënëve që mungojnë në vendngjarje ..?!
- Kam dëgjuar nga studiuesi serb N. Kilibarda në një paraqitje televizive të jetë shprehur se si vetë murgjit serbë deri në shekullin e 18-të, nuk u kishin thënë popat e tyre të kishin folë për mitin e Betejës së Fushëkosovës që lë për të dyshuar se kjo betejë që na përshkruhet sot të jetë një trillim i murgjve rus të Hinlandarit e që në fakt ishin të gjithë gjeneralë rusë të maskuar në velon kishtarë pas marrëveshjes ruso turke dhe me autoritetin e Rusisë me fuqitë evropiane kur vendos për paqen e Kurëunkurnamesë – Bullgari. Vetëm aty u vendos që popullsive të krishtera serbogreke tu jepej automomia e pushtetit lokal e cila nuk përfshinte popullsinë e krishterë ortodokse shqiptare dhe që kjo nënkuptonte se i gjithë kleri ortodoks shqiptar fillimisht për ca kohë do të duhej të zëvendësohej me murgj të dërguar nga kisha ruse e që në fgakt rezultoi që të gjithë të ishin gjeneralë rusë të cilët filluan të trillonin edhe mitin për lufrat e shpeshta të gjoja serbëve ndaj turqisë , pra edhe për betejën në Fushë Kosovë, kuptohet pasi përvetësuan edhe Manastirin e Hinlandarit. i ndërtuar nga fisnikët shqiptar dhe i mirëmbajtur prej tyre i cili mjerisht edhe sot është i ndaluar për vizitorë shqiptarë , kurse siç u cek ishte GjonKastrioti ai i cili e mirëmbante atë gjatë gjithë Kohës. Po të shikoni teknikën e ndërtimit të këtij manastiri del të jetë i ndërtuar sipas traditës së arkitekturës shqiptare dhe se serbët jo atëherë , por a sot nuk kanë gurëgdhendsa të tillë sepse ambientin e kanë të rrafshhtë si në stepat ruse. Tjetër , me vendim të fuqive evropiane edhe sot ky teritor nuk guxcon të jetë i hapur për vizitorë apo studiues shqiptarë pa cka se vetë serbët në dokumentet e vjetra e quanin ALLBANSKI PIRG apo KULLA SHQIPTARE. Ky këmbim i kleri shqiptar me mugj rusë , serbë dhe grekë është edhe sot në fuqi . Brenda nuk shkelë këmbë shqipëtar?! Ndërsa edhe më vonë thuhet që edhe në lufrat e fundit në ish-Jugosllavi falë statusit të ekksteritorit në këtë Mal u fshehën në emër të shenjtërisë ortodokse serbe kriminelë lufte . Tjetër , pastaj vazhdon Novak Kilibarda i njohur se si murgjit sebë ishin ankuar dhe kishin thënë se si ata fare nuk kishin dëgjuar më parë nga popat serbë as për trimërinë e serbit Millosh Kopiliqi që vrau Sulltan Muratin në çadër dhe që për këtë punë nuk kanë asnjë këngë , përveç se - po , kanë shqiptarët...?! Prandaj sot kisha ortodokse serbe motivon një folk të ri ku flitet për do ngjarje nga trimëritë serbe mbi turqit që më parë nuk ekzistonin
- Andaj edhe sot beteja e cekur për disa ngjason jo si një luftë e të krishterëve me turqit , por më shumë do duhej të ishte si një komplot i simuluar i të dy oborreve : në Serbi dhe Stambollë ...?! Kuptohet i kurdisur për të marrë pushtetin brenda familjes së sulltanit pasi të kishin vrarë pretendentet e 2 froneve , atij të Stambollit dhe atij serb që edhe realisht ndodhi nga dy familjet dhe që më pas me qëllim politik u mitizua. Po cilat janë arsyt dhe qëllimet e mitizmit në kohë që ndodhi dhe vazhdon të ndodhë edhe sot nga ky konspiracion gjeoçilitik të kësaj teorie që si ngjarje ciklike kanë ndikuar e ndikojnë në motivime të ndryshme në kohë, po përmendim disa sish që janë :
- Menjëherë pas vrasjes së babait - Sulltan Muratit në betejën e cekur dhe vrasjes së - Car Llazarit nga Vuk Brankoviqët në anën tjetër vërejmë se në fushëbetejë nënshkruhet

menjëherë paqja ndërmjet Vuk Brankoviçit dhe Sulltanit i cili edhe pse e mundi sulltanin sipas burimeve serbe- Brankoviç pranon të jetë sërish një Vazal i Stambollit?! Pra duket që marrëveshja ishte paraprakisht e nënshkruar me turqit në rast që komploti nuk dështon .

- Dhe po të mos ishte kështu atëherë si ndodhi që e shoqja e Car Llazarit ndante shtratin e haremit të Sulltanit me një vetëdëshirë duke harruar ish burrin e saj princin serbë që fundi i fundit del se ishte si veprim i njohur serbë gjithnjë në kohë të ndryshme të historisë së tyre?!
- Nga ana tjetër asnjë fisnike shqiptare apo femërmalësore e grabitur nuk përfundoi kurrë në harem të sulltanit..
- Si falsifikime tjera të fakteve historike për llogari të serbëve e në dëm të shqiptarëve është edhe filmi për Sulltan Sylejmanin e Madhërishtë, prodhim turk , kur shohim që Ibrahim Pasha – Pargalija- shqiptar i oborrit në skena filmi , babanë e vet del se e ka të veshur me tesha kombëtare serbe të shekullit 18-19 ?! , dhe jo me tirq...?! Ndërsa harrohet fakti se në atë kohë kur jetoi Ibrahim Pasha - serbët ende nuk kishin arritur të kenë veshjen e vet kombëtare dhe se” shajkaçat “ e “shubarat” serbe lindën nga uniformat ushtarake të cilat armatat evropiane iu dhanë serbeve si uniforma të Luftës së Parë Botërore .Kuptohet që pasi nuk kishin makina për bërjen e uniformave ushtarake serbëve uniformat e tilla iu qepnin ushtritë e huja të aleancës evropiane me serbët jo që ishin antiturq , por sepse si popull ishin më shumë antishqipëtarë .
- Dhe që për ngritjet në kohë të ndryshme të mitit të pa qenë, tash më të njohur si : ” Të krishterët kundër gjysmë hënës , gjoja ”si kujtesë historike e kohës serbe u përkujdesën vazhdimisht të përsërisin pompozitetin madhështor në prag betejash deri në ditët tona që nga ajo betejë q me qëllim u mitizua. . E ngjashëm punoi si formë kujtese nga ana e tjetër , si rreksion , mbase edhe ky i kurdisur nga e njëjta dorë e formimit të kombeve të rteja , si serbët , grekët etj, çka vërtehet si imitim edhe veprimi i vetë Sulltan Hamiti në vitin 1911 që kur i dorëzoi shqiptarët te serbët në vitin 1912 , mbi bazën e arsyeve gjeopolitike shënohet se kish arritu nga Stambolli me tren deri në Shkup , dhe ku pikërisht në ditën e betejës njëditore sebotuke mu në Ditën e Vidovdanit , aty te Tyrbja e Sulltan Muratit mbledhi rreth 500 mijë shqiptarë në xhumanë lamtumirëse duke shtuar se përsëri shumë shpejt do të kthehet në Kosovë...?!Duke dëshmuar se si gjeopolitikë Turqia nuk do të tërhiqet edhe pas 500 viteve?!Por që pas kësaj për shekuj vazhdoi një pastrim etnik i shqiptarëve në Anadoll dhe që nga kjo datë , Kosova qe vazhdimisht nën një gjendje të jashtëzakonshme
- Përsëri më vonë mbi bazën e mitizimit shteror serb të ditës së cekur që ndodhte nën bekimin e kishës serbe ,mu në këtë ditë –si jehonë të asaj beteje , pas 500 vjetëve, vërejmë se si në vitet e 90 –ta edhe Slllobodan Millosheviqi duke imituar Sulltan Hamitin e për ti thënë se ende këtu jena ..., mbledhi edhe ai në Fush Kosovë 1milion serbë duke i motivuar për ndeshjen e madhe të Kryqit me HYLL e HANË në nivel të gjeopolitikës dhe kuptohet kundra shqiptarëve


- .Po dhe mbretëria Serbokroate dhe Sllovene ishte formuar mu në këtë ditë duke miratuar edhe kushtetutën serbe të Vidov Danit të mbretërisë së tre popujve ?!!Kujto se si kjo kushtetutë u pagëzua në shenjë të asaj beteje të famshme serbe e të cilën faktikisht e kishin humbur që do të thotë se del të jenë bërë kompleksiv sepse nuk mbahet mend që një popull humbjen e vet kolektive ta shpallë për datë tëshenjtë kombëtare , por edhe shpirtërore , Thjeshtë festojnë humbjen për fitore?!
- Por edhe më pastaj në mënyrë sdimbolike edhe heqja e autonomisë së Kosovës u bë mu në këtë ditë- pas trazirave të 1981-shit ?! E kështu po del se edhe Jugosllavia si krijesë të ishte formuar për të luftuar shqiptarët si komb në ish Jugosllavi , apo si të thuash dikur ILIRI?! .Çka në të vërtetë kështu edhe ndodhi , sepse me formimin e ish- Jugosllavisë në Kosovë gjithnjë patëm një gjendje lufte duke i shpërblyer serbët për atë luftë me turqit e duke i shpërngulur para syve të Evropës 1 milion shqiptarë për në Turqi pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore e cila në Kosovë zgjati deri më luftën e Uçk-së dhe ndërhyrje të Natos. E që edhe këtu , del të kemi një situatë tepër konspirative , pasi institucioni i Kombeve të Bashkuaranuk firmosi që të sulmohej Serbia , por as Presidenti Rugova, e as Presidenti Nano , e as Berisha nuk kishin nënshkruar kërkesën që Nato të ndërhyjë ushtarakisht e bile as presidenri turk i kohës. Por Amerika pranoi të luaj vetë xhandarin
- Por sprapseprap u vërtetua se si shqiptarët janë popull vital dhe flijojnë shumë për lirinë e vet dhe edhe të okupuar arritën të ndryshojnë situatën në gjeopolitikë përmes vetëorganizimit të pushtetit paralel në Kosovë e deri te fillimi i Luftës së Amatosur , pa çka se serbët faktikish pushtuan kosovën me ushtri të veta.
- –Ndërsa kush ka mundur me intuitë të shikojë kalendarin e ndodhive , pa dyshim ka hetuar se si edhe Milosheviqi ditën eVidovdsnit kishte shkuar ngjashëm me helikopter për në Fushë Kosovë duke proklamuar në prezencën e klerit serb për fillimin e luftës së shenjtë...,duke thënë fjalitë “ LE TË JETË STAMBOLLI SERBË” . Ndërsa për ironi të fatit të tij shumë shpejt mu në këtë datë të zbritjes së tij me helikopter në FushKosove për të kërcnuar shqiptarët duke tubuar atje 1 milion serbë me urdhër të ndërkombëtarëve mu në këtë datë u grabitë nga njesitë speciale serbe të kryeministrit Gjingjiq për Vidovdan , por tashti nuk u nis për Fushkosovë , por nga rruga pa kthim në Hagë .E komandanti i operacionit që udhëhiqte grabitjen ishte kryeministri Gjingj.
- Dhepas kësaj atë ditë e sot në ditën e Vidovdanit , pas 500 viteve , serbët për arsye sigurie-siç thanë nga Kisha Serbe – tubimi përkujtimor i ditës nuk u bë më në Fushë Kosovë , por në Manastirin e Deçanit ..?!
- Për të përfunduar rrëfimin jo pa qëllim këtu duam të cekim se si në kohën e Luftërave Ballkanike (1912) Amerika, si forcë e re gjeopolitike botërtore karshi Evripës plakë , kishte pranuar shtetin shqiptar qysh më 1912 edhe pse trupat turke atje mbetën deri në vitin 2015 kurse edhe kufijtë e këtij shteti ende nuk njiheshin ..?!
- Kjo do të thotë se ata me aktin e njohjes morën edhe përgjegjësinë e njohjes së kufijve të shtetit . Për çudi edhe presidenti Xhorxh Bush, nuk përzgjodhi asTiranën e as

Prishtinën të kumtojë lajmin e pranimet të Kosovës shtet por e bëri në Krujën e Skender Beut?!



Shpërngulja e Madhe Serbe TABLLO nga **PAJO JAVANOVIQ** : *Shih prijësi dhe truproja e klerit të veshur me tirqë del të ishin shqiptarë...?! Po të ishte autori shqiptar do të na akuzonin për përvetësim të historisë së tyre. por jo Pajo Jovsnoviq është serbë.*


PO DHE ORAKULLI I PARË I BOTËS PELLAZGJIKE ISHTE NË RUMI SIPAS HARTËS SË ALBANOLOGUT GJERMAN HAHN ?!



Duke shkruar një histori 8 mijë vjeçare për besimin në një Zot e cila u bë bestseler duke u shitur në miliona kopje autori i saj - KAREN ARMSTRONG pasi flet në mënyrë krahasimtare për histotikun e feve , jep edhe mendimin e tij se si shteti më i vjetër

monoteistë i botës i quajtur shteti NË FILLIM shtrihej në gjeografinë e Shqipërisë . Për çudi me këtë fjalë që hapen gjithë shkrimet e shenjta sot e njeh vetëm shqipja duke u vërtetuar se kjo fjalë është me etimologji të qartë shqipe . Ndërsa po kjo hartë e vendit në fillim dhe e popullit në fillim që dëshmohet si rrënjë fjale me kuptim ungjillore do duhej të kish qenë njëkohësisht edhe vetë vendi në hartë ku u paraqit përherë të parë shteti teokratik i thrmeluar nga etërit e parë të ngulmimeve hebraike e nga të cilët sot trashëgojmë fillet e mendimit monoteistë që është se Zoti ka ekzistuar , ekziston dhe do të ekzistojë si i pa fillim dhe i pa mbarim. Nëse gjurmojmë nga këndi etimologjik i fjalës në këtë libër të nobelistit Karen atëherë na del që sipas shqipes fjala mund të jetë edhe fjala e parë të cilën Zoti shpalli fjalën e shenjtë të prezantimit të rkzistencës së vet . E cila nga aspekti gramatikor i shqipës del që sikur është edhe një dëftore e fillimit të vetë Zotit , sepse gjuhësisht mund të jetë edhe një gegërishte me kuptim të qartë i thënë NË+FILI+ IM, pra Zoti shpall - rrëfen për vete historinë e fillit të Titj duke treguar në shqip edhe vetë fillin e ekzistencës së Zotit që është vetëm mendim , fjalë e cila nga e thëna e parë u materializua në dritë. Sepse Ungjilli thotë që fjala e fillimit u bë dritë . Dhe pikërisht në këtë shtet autori thotë se si u paraqiten edhe ngulmimet e para të etërve hebraikë . Shih në fillim si nocion kuptimor gjithnjë në vete përfshinë edhe kuptimin e shpalljes së parë apo ZBULESËS.

Nga ana tjetër edhe albanologu Hansi gjerman në vegimet e veta , pat vendosur në këtë hapësirë edhe permendoren tempullin e parë të kohës së parë që ishte ngritur pikërisht në këtë hapësirë të shtetit të quajtur në fillim e që më saktësisht i bie të jetë në bjeshkën Rumisë – pra në vendin ku paraprakisht kish jetuar populli më i vjetër i botës edhe Tempulli i Parë i Njerëzimit të njohur tashmë si DODONA ILIRE e cila i përkiste një civilizimi të zhdukur që kapte – përfshinte, hapësirën bregdetare Shkodër –Rumi – Tivar Kotorr dhe se nga ana tjetër kjo çështje ka edhe mbështetje historike arkeologjike sepse këtu u paraqit edhe njeriu i parë besimtar i njohur nga arkeologët edhe si Homus Adrikus – pa dyshim i rënë si alien nga qielli. Kurse ky njeri gjuhësisht del të lidhet në çift edhe me vetë Evën , apo Havanë me emrin e të cilës sot identifikohet vetë qielli duke u quajtur edhe HAVA. Tjetër në të mirë të këtij arsyetimi është edhe një shprteheje me kujtesë po duket historike religjioze që është “ A mos ke pik nga qielli” . Në kuptimin e njeriut të parë të zgjedhur që nuk haset si frazeologji tefqinjet sllavë të cilët me sa shihet nuk e trahëgojnë këtë dije të origjinës hyjnore të njeriut të parë. Dhe ngjashëm në kujtim të kësaj rënie nën Rumi kupollës qiellore i thonë edhe HAVA e Havaja, besimi na mëson se si ishte femra e parë që ra nga qielli , si bashkëshorte e Ademit dhe ku normal që lindi sipas kësaj logjike edhe njeriun e parë besimtarë të cilin cekëm se arkeologët e vendosin buzë detit Adrtiatik. .



Shih edhe këtë hartë të cekur të përmendorës –Tempullit të parë të një race besimtare paraprake që ne trashëgojmë pas një rivendosje nga lartë e cila u zëvendësua një racë tjetër që i bie të jetë raca jonë pas një katastrofe natyrore të kohës të kontinentit pellazgjik duke përfshirë gjithë territorin shqiptar nga Tivari dhe drejtë gjithë pellgut të Detit Adriatik , Mesdheut Detit Egje Mesdheut Lindor , për gjatë brigjeve të Izraelit e duke prekur hapësirën e lumenjve Tigër dhe Eufrat...?! Për këtë orakull të racës së shkuar si qyterim faktet flasin që vërtetë i bie të ketë qenë i përmbysur dhe i përmbysur mu në këtë hapësirë dhe se si dëshmi mund të jenë sasi të mëdha të mermerit të kontinentit që u përmbys i cili gjendet në thellësi të kësaj toke të cekur. Që do të thotë se i bie që dikur ketu të krtë qenë vetë “Vendi më i pastër në Tokë” e që nënkupton edhe tempullit më të parë të atij civilizimi që pësoj rivendosje nga raca jonë ekzistuese . Po dhe sipas përmbajtjes së Barkës së Nuhut sipas toponimisë që trashëgojmë sot në shqip mund të arsyetohet teza se si pas përmbajtjes dhe tërheqjes së ujit Ballkani të ketë qenë vetë vendi ku arriti pëllumbi mitik , apo Zogu , apo dy Zogj apo dy pëllumba të cilët patën folur se si këtu në Epir ish tërhequr uji dhe shihej toka E PIRË , pra që ishte epir (Epër) , sepse kish pirë ujin nga ku u ringtit tempulli i orakullit të DODONËS pellazgjike që iu parapriu ilirëve ..?! Pas ngjitjes së Faltorës Tempullit të Dodonës sërish në këtë vend , pëllumbi kish folur mesazhin hyjnor duke treguar fatin se çka të priste – gjatë jetës apo edhe vdekjes popullin nesimtar dhe kjo nuk është se ishte vetëm fall- parashikim por besohej që ishte vetë mesazhi i dijes hyjnore se si duhet të ndërtohet morali apo feja e zbritur në këto anë në këtë detë , poshtë Malit të Rumisë që edhe sot ruhet- njihet me këtë emër , që është TEA –SEA që në fakt i bie se quhesh FEJA ...?! Besohet se komunikimi me botën tjetër në këto anë me mesazhe e bënin femrat – priftëreshat e tempullit që dinin të lexonin vibrimet e valëve energjitike që bartëshin përmes fëshfërimave të koduara të

gjethve të lisit i cili çmohet si pemë e shenjtë në folklor dhe këtë e vërtetojnë edhe vargjet e këmgës baladike si , për shembull: “ Oj Rumija bjeshkë e naltë , kur ta mora majen ty , mora dertin o me sy, në mjedis të detit o/ ish një lis i vogël-o, sai vogël lisi ish , sa hije të madhe kish , ku mrizonin 9 ogiç , 9 ogiç me 9 kumonë të gjithë bsdhkë po i rrotullojnë , pikok lotja synit zi , nai ra dilberës na sy , u ngri deti akull-o metën barkët shakullo...Dhe kur njeriu arrinë e dëgjon këtë këmgë plot kode folklorike me pozita të një surealizmi po themi francez çdo njeri i zakonshëm doemos që do mahnitej , kurse neve këto kode mendojmë që i kemi çkoduar në librat tanë .

Më vonë njeriu i Homoadrikusit si duket u inspirua shpirtësisht nga energjitë e Universit të Qenies Supreme. Ose edhe u udhëzua– aftësua që komunikimin me të padukshmen ta bënin edhe me anë të metaleve, si me plumb , me ujë duke shfrytëzuar dridhjet zanore të tyre etj.

Zakonisht në këto orakuj- Tempuj kanë shërbyer për komunikim 3 faltore (fallxhore mitike)- murgesha të Faltorës që “ e qitnin fallin(e nxirrnin fjalën) nga atje lartë ku rri i shkruar) dhe që poashtu edhe kjo emërtohen kuptueshëm me emra vetëm të etimonit(e+ti+ mu) shqip, si PERMENEJA –në dialekt kështu i thonë edhe sot PëRMENDJA , pastaj NIKANDRA , zbërthyeshëm në dialekt N(ndi)+ka+ andra , pra ka dëgjuar nga ëndrra ?! Dhe TIMAREJA = TI+ mar+eja apo një dëshirore; Ti e mbarë eja- dhe mos më krijo probleme?!- Mos hajde “me sherr në krah “ që është një frazeologji nën Rumi...?!Kujtojmë që me këtë emër TIMAR njihet edhe prona së posedonte një feudal- fisnikë. Që nuk ish i ardhur në një vend.

Vetë dialekti i të folmës së Rumisë sot na jep të drejtën të shpallemi trashëgimtarë të këtyre dijeve sa ezotertike aq edhe okulte.

Në fillim nga njohësit e këtyre çështjeve thuhet se këto femra që parashikonin fatet kanë qenë vajza të reja , por ngase pat ndodhur dhe i grabitën banorët e qiellit që vizitonin tempujt , atëherë , këta të Tokës nën Rumi-Dodonë, mbajten kuvend dhe ku u vendos të ishin femra mbi 50 vjetë që mund të shërbenin në Tempullin e Dodonës apo tempujt e Dodonës pa ndonjë rrezik , ky është një mendim i huazuar nga tjerët. Shtojmë se teza që faltorja e parë e njerëzimit të ketë qenë pikërisht në këto anë është në faktin që siç thoshte frimasoni shqiptar Besim Zotaj se pikërisht nga ky nënqiell ekzistonin rrugët më të shpejta ndërplanetare dhe qiellore pasi ky nënqiell ka gravitetin si dukret më të vogël dhe është si një portë qiellore kuptohet në orë të caktuara ...?!

Tjetër gjiathashtu besohet se si- një lloj ore , në këto anë ishte edhe vet gjarpri ,i cili emrin ora e ka për sinonim të vetin dhe të cilin e quanin PITON , në fakt në dialekt i bie të ishte PITHONË(Po i thonë)?! Ngase evropianët del që nuk e kanë germën TH , të njohur si lloj energjie – germë , që bartë në vete edhe vetë emri. e zotit të dijes Totit , apo Thotit andaj edhe sot këtij gjarpëri i thonë ngjashëm PITON., pra pithonë një gegërishte ..?!! Kurse edhe

vetë njeriu që lindi nga çifti tokësor dhe qiellor ILIRI thuhet se ishte një njeri në trup gjarpëri për çka kemi folë mjaftueshëm në librin tonë për Shasin...?!!

KUSH JANË GEGËT DHE KUSH JANË TOSKËT –SIPAS MITIT DHE TRADITËS

Dokumentet arkivore që lidhen me parahistorinë dhe historinë e shpjegojnë mitin e gegëve dhe toskëve se, janë të lidhur nga i njëjti fis në origjinë dhe se njëri shtrihej në jug dhe tjetri në veri të Arbërisë duke qenë edhe te një barku .

Me këtë fis , miti thotë se fillon edhe sistemi i perëndive në tokën që ne njohim . Kupto që i bie të ishin alienë që zbritën në planet disa herë në tokë , pas shumë katastrofave qiellore që bëheshin si ndëshkim i cili pasohej nga rivendosjet e vazhdueshme. Dhe kjo është fare e kuptueshme sepse në përmbajtje dhe formë edhe shkencërisht është vërtetuar që qoftë edhe një spermatozoid i vogël , ka formën e një njeriu këmbë e duar hapur që kur të shikohet merr formën e një ylli, pesëcepëshi . Dhe ky argument shkon në dorë të teorisë se si në formë bota materiale e dukshme dhe ajo e padukshme në fillimin e saj është identike . Andaj merret për simbol të dy botëve, vet yllin (pesëcepëshi) i cili kur është dritë simbolizon njeriun kurse kur është flakë simbolizon djallin. Dhe se pasi çdo gjë ndodhi te YLLI MADH lart në qiell i bie që ajo u përsërit në planetin tokë , kurse ai vend në tokë i bie që në shkrimet e vjetra të besimit të jetë fjala e parë dhe se quhesh NË FILLIM në të gjitha gjuhët e librave të shenjtë kurse fillonte në hapësirën e cekur ku ndodhet arbëria ose në vendin që quhej NË fillim apo edhe më thjeshtë siç cekëm TOKA ZEMËR QENDËR E PLANETIT , ku i bie të jetë qyteti në tokën qendër icili në vete fsheh rrënjën YLL dhe është pse jo Ulqini , shih më herët nga rilindasit ky quhej Ylqini . Sa për origjinën e cekur të toskëve dhe gegëve që edhe sot jetojnë më vendin në fillim , merret vesh se si sistemi i tyre i dijeve mitologjike sërish fillon me kode të dijes së fjalës shqipe për nga orientimi . Ai sistem filloi me VRANIN që si zakonisht emri apo folja vepruese vrani përsëri është fjlë shqipe , si vrant – mot i vrant “Vrancija”–AnaMalit (vranësira)- MOTI VRANËT-Qielli Vranët. Vrani thotë miti , u martua me tokën –Dheun (GEAN). Ndërsa Vrani , kishte dy gra shqiptare për nga emri , që njëra quhesh TITIJA (praTOKA) dhe tjetra quhesh GIGIJA – pra prapë Toka. Dhe nga TITIJA janë TITANËT (TI+ tanët= të tonët- të gjithë tonët) , kurse plotësojmë nga këndi i etimologjisë shqipe se si gjuhësisht Tokës i lind tingulli S që si tingull është barszi me fjalinë TI+ NGUL , pra mbjell e cila në fjalë para K-së jep emrin e ri toskët .

Në fakt , është vërejtur që nëse fjalës i heqim vetëm një germë ; s –në, si energji kozmike sepse fjala formohet nga energjia e të gjithë Universit do të vëreni se kjo është e pamundur fare ngase të grupi i bashkëtingëlloreve TOKS në shqip , ka kod energjie që është i pa ndarë , pra logjikisht del se nuk mund të kuptohet toka , pa emrin TOSKË. Prej këtu kuptojmë që emri TOSKË vjen nga Toks. Kujto nl gegëri kemi një nëmë T KAPT E TOKS(ridhjet e tokës-Epilepsia). E së ka diçka këtu më së miri për funksionin në tokë dhe Univerrrs te toskët dhe gegët më së miri na e simbolizon vetë veshje edhe kërcimi i tyre ritual . Përderisa Gega me tirq të leshtë xhamadan dhe qeleshe të bardhë , sikur imiton njeriun që

nuk shkëputet nga toka , ashtu sikur edhe një gjarpër (si vet iliri) , ai i tokës –Toska me veshjen e vet – fustanella e tij sikur simbolizon origjinën e vet në tokë nga qielli –Vrani i bërë për fluturim . Edhe sot në Euroazi si një gjeogrsfi jo e largët kemi një vend që quhet LEVANTI , pra Le vendin (fluturon) duke na kujtuar shtrirjen gjuhësore gegëve reptilianë . në veshje -me tirq , pra vetë para malësori i këtyre anëve dhe në LEVANTI - toska me fustanellë të tijën duke treguar edhe me veshje e gjuhë veprimet që kryenin këto dy fise të para të fillimit që ruajnë si bijt të Varnit deri në LEVANT – lë vendin-fluturon lartë ashtu si një zog – pra një shqiponjë ?!

Dhe kështu te një veshje malësore si në fotografi , qeleshja tregon kujtesën në vezën e madhe kozmike gjysma etë cilës mbeti në tokë . Vijat e zeza në tirq tregojnë vetë kadmilon (strukturën anatomike të eshtrave) dhe se e bardha dhe e zeza tregojnë vetë neutralitetin e tij si gjarpër , po qese nuk e sulmove, ndërsa gjërat e leshta në vete janë hyjnore duke absorbuar mesazhin hyjnorë .

Shih për shembull edhe Jezusi kur dëshironte të komunikonte me lutje drejtuar qiellit dihej se veshej jo kot por për një funksion teshat e leshta.

Nga ana tjetër të fotografisë që sjellim kemi femrën malësore e cila na del të ketë një mënyrë speciale të lidhjes së kokës e cila në fakt ngjason me lidhjen e kokës së mbretërëshave të mesjetës apo të njerzve me ststus aristokratik njerëzor po dhe me status të njl dijetari , filozofi, princi etj dhe se në ta të gjithë zbukurimet e formave të argjenda sikur kanë funksion të kapjes së tingujve të shenjtë për nga energjia të Universit , Dhe për deri sa xhubleta e zezë tregon vetë formën e shenjtë të Universit që ka formën e një kembane gjigande e cila ka formën e një uje të përmbysur , apo si një këmbanë kishe të kujton në dije se kështu do duhej të ishte edhe vetë tingulli i parë i Universit që ishte vetëm sa një zë – pëlcitje në për një çasti pëlcitës për aq sa zgjati edhe vetë pëlcitaja që është një BUMMM duke treguar se ai zë binte nga pika më e lartë , në raport me shikimin tonë të syve në horizont . Dhe kur ky tingull binte nga lart deri në sipërfaqe , duke mos depërtuar poshtë saj jepte tingullin Bim . Kurse në të kundërtën nga toka lart në shqip kemi kuptueshëm shqip tingullin BAMMM .Shih gjuhët e fqinjve për vetë faktin se nuk kanë njohurinë elementare të fomave bazë dhe zakonisht del se nuk injohin në fondin e gjuhëve të veta këta fjalë të quajtura edhe si onomatopeike atëherë kot se edhe u kërkon të u shpjegosh edhe dijet tjera të këtyre tingujve që mendja e gegës dhe toskës i kapin por mendjet e tyre si gjuhë të rteja nuk i kapin . Këtu zakonisht hyjnë shprejet e tingujve TINGUL –pra sikur vetë gjuha e dijes shqipe na mëson se TI NGUL, po ngul një dije e për të mos folur për shprehjet malësore taralash , rrababam ose rribibim e rrububum sepse nuk kanë vend për regjistrim në trurin e vet dhe kjo ka habitur shkenctarët e gjithë botës, duke idhënë shqipë satatusin e gjuhës së parë . Mendojeni në vete se si fjala parë nënkupton: një çift – mashkull dhe femër, një folje PA+ RA , pra pa rënë, por edhe pa(parë) dhe ra (rënë). PA RËNË(para)ose e pa dhe ra . Për konkretizim vizuel shih fotografitë e sjella :



Një xhubletë realisht del se ka krahët e një shqiponje që e simbolizon , po edhe të një këmbanë të tingullit të shenjtë që thamë se ishte edhe tingulli i parë i “ pëlçitjes” së parë të fjalës së çastit të Universit. Shih këtë kuptim ka në librin e shenjtë se “në fillim ishte fjala dhe fjala u bë dritë”. E për malësoret mu për këtë fjala burrit është e shenjtë dhe se “burri lidhet për fjalët të shqiptarët”?! Kurse një përparëse e kaltër në trupin e malësorës tregon “vija e peshkut në ujë” . E kaltërta është për shqiptarët zanafilla e jetës është uji. Kupto për mes veshjes me simbolikë që jeta e saj nisi në ujë – këtë na kujton emri i shenjtë IPESHKVI . Kjo nga këndi mitologjik të kujzon fatin e vetë Harmonija (nëna e ilirit) që ishte një femër në trup peshku dhe bijë e Afërditës qiellore ...?! Kështu komplet veshja malësore në tërësi sikur imiton vetë shqiponjën e maleve dhe kështu kur takohen dy malësore si në fotografi me krye të lidhur me një petk të zi si rrip ,si në fotografi sikur dëshirojnë jo pa qëllim të duken sikur imitojnë atë kur bashkohen dy shqiponja të zeza..?!

Po ashtu në hierarkinë e vetë familjare të shenjtë kur i drejtohen burrit të vet i thonë I ZOTI SHPISE e nuses së djalit i thonë Zoja shpisë , kurse fëmijës së vetë i thonë Zogu shpisë . Dhe ku tjetër përveç se në Malësi ruhen këto emra të origjinës hyjnore të hierarkisë familjare në botë. E këto tituj të origjinës së vet hyjnore që ruan familja malësore sikur janë harruar edhe në gjeografinë tjetër kombëtare . Kështu fjala vjen të thuash për djalë në Kosovë e gjetkë se ky është ZOGU JEM të qeshin ..?! Andaj ruajtja e këtij fjalori

me origjinë hyjnore të klerarkisë familjare u ruajt përveç se në Librat e Shenjtë edhe në Malësi , ku i bie të jetë në harta ajo që u cek : VENDI-SHTETI NË FILLIM?!!!

Muhamet nika –për Kohën Javore